

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË TREGTARE
DeliArt 100 SH.P.K
ME SELI NË TIRANË

Sot, më datë 20.10.2023 (dymijë e njezetetre), ortakët:

Zj. Albana Mustafaraj, e bija e Zyhdi, e lindur më 15.07.1970 në Tirane, banuese në Tirane në Rrugën e Barrikadave, pallati nr.26, apartamenti 39, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me nr. personal H05715181E, datë leshimi 14.01.2019;

Zj. Genta Shijaku, e bija e Zyhdi, e lindur më 28.10.1967 në Tirane, banuese në Tirane në Rrugën Bajram Curri, Hyrja 1, pallati nr. 121, apartamenti 6, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me nr. personal G76028030C, datë leshimi 13.07.2020

të cilët përpiluan këtë kontratë themelimi të shoqërisë tregtare DeliArt 100 Sh.P.K, me termat e mëposhtme:

NENI 1

Shoqërinë Tregtare DeliArt 100 SH.P.K, është formuar si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901 e datës 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar (në vazhdim Shoqëria).

Shoqëria është Person Juridik Privat Shqiptar.

NENI 2

Emri i shoqërisë


Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin **DeliArt 100 Sh.P.K**

NENI 3

Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë shtrihet në fushat e mëposhtme:

Tregti me shumicë e pakicë, Import Eksport, të produkteve të përpunimit artizanal të ushqimeve BIO Organike , artikuj artizanale, produkte industrial dhe jo industrial, tregti artikuj ushqimore, pijeve alkolike, çokollata dhe kremrat e prodhuar prej saj, pijeve freskuese, kafe, çaj, frutave të thata, erëza, gështenjave, kërpudha, vajra bimore etj, Tregti import-export i të gjitha materialeve ushqimore të freskëta, të ngrira e të konservuara. Tregti produkte ushqimore si peshk, mish, sallam, djath, vaj, conserva, salcë, produkte të embla furre, verëra dhe produkte të distiluara, pije freskuese, lëngje frutash etj. Paketimi dhe tregtimi i erëzave dhe frutave të thata Delivery, shpërndarja e produkteve të tregtuara në adresat e klientëve sipas porosive, online dhe fizike. Tregti, import-eksport bimë medicinale. Pajisje elektronike, elektrike, pajisje guzhine, prodhimin dhe tregtimin e artikujve të pastičerisë, ëmbëlsirave dhe të brumrave, të xhelaterisë (akulllore) me lëndë të parë dhe shitjen e tyre; prodhimin dhe



tregtimin e kutive për ambalazhimin e ëmbëlsirave dhe produkteve ushqimore. E gjithë veprimtaria e shoqërisë pavarësisht nga objekti i saj do të mbështetet në licencat e lëshuara për këtë qëllim nga organi shtetëror përkatës.

NENI 4

Selia e Shoqërisë

Selia e Shoqërisë ndodhet në Qytetin e Tiranës, në adresën: Rr. Bajram Curri, nr. Pasurie 7/78-N 3/2 zona kadastrale 8360

NENI 5

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie në para në vlerën 500.000 (pesëqind mijë) lek , e ndarë në 2 (dy) kuota. Kuotat e kapitalit themeltar të shoqërisë janë të ndara si më poshtë:

1. **Zj. Albana Mustafaraj** në cilësinë e ortakut themelues zotëron **51%** të vlerës së kuotave në kapitalin themeltar ose 1 kuotë të barabarta me vlerë prej 255000 lekë në kapitalin themeltar.
2. **Zj. Genta Shijaku**, në cilësinë e ortakut themelues zotëron **49%** të vlerës së kuotave të kapitalit themeltar ose 1 kuotë të barabarta me vlerë prej 245000 lekë në kapitalin themeltar.

Kapitali themeltar është investuar nga partnerët themelues në total. Vlerësimi dhe pagesa e kapitalit themeltar është kryer nga Partnerët Themelues në rast të miratimit të kësaj kontrate themelimi dhe të firmosur nga ta.

NENI 6

Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar. Afati i aktiviteti fillon mbas regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar dhe mund të zgjatet ose shkurtohet, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve.

NENI 7

Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratorët – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë. Shoqëria do të administrohet nga Administratorët të cilët zgjidhen për një afat pesë vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

Administratori i Shoqërisë do të jetë Zj. Albana Mustafaraj, e bija e Zyhdi, e lindur më 15.07.1970 në Tiranë, e banuese në Tiranë në Rrugën e Barrikadave, pallati nr.26, apartamenti 39, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me nr. personal H05715181E, datë leshimi 14.01.2019;

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratorët, të cilët i ushtrojnë këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi

NENI 8

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 9

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdurojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 10

Ligji i aplikueshëm

Veprimtaria e shoqërisë rregullohet nga rregullat e Statutit të firmosur nga ortakët themelues sipas parashikimeve të ligjit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 11

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis ortakëve apo midis ortakëve dhe Shoqërisë dhe të cilët mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve të tyre me shoqërinë do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.


NENI 12

Dispozitat përfundimtare

Akt Themelimi hartohet në katër kopje në gjuhën shqipe dhe u lexua dhe firmos me vullnet të lirë nga Ortakët Themelues.

ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË TREGTARE DeliArt 100 SH.P.K

Zj. ALBANA MUSTAFARAJ

Albana Mustafaraj


Zj. GENTA SHIJAKU

Genta Shijaku
